



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 4381 Prot.

Tiranë, më 26/10 2021

UDHËZIM

Nr. 456 / Datë 26/10 2021

**“PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 713, DATË 11.10.2018 “PËR TARIFAT
E LICENCIMIT TË VEPRIMTARIVE, TË CILËT PËRDORIN BURIME TË
RREZATIMIT JONIZUES”**

Në zbatim të nenit 7, gërma “a” të Ligjit Nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

Në Udhëzimin Nr. 713, datë 11.10.2018, “Për tarifatat e licencimit të veprimtarive, të cilët përdorin burime të rrezatimit jonizues”, bëhen shtesat si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 1 të Udhëzimit, shtohet pika 1/1 dhe pika 1/2 me përmbajtjen si vijon:

“1/1. Tarifatat e përcaktuara në këtë Udhëzim janë për çdo burim ose pajisje për të cilën realizohet ekspertizë.

1/2. Për procedurën e rilicencimit të veprimtarive që nuk kanë ndryshim në ekspertizën e kryer, paguhet gjysma e tarifës së përcaktuar për licencimin e veprimtarisë”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

